




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. B-Prot. 01-997/13
Nr. i faq. Broj. stranica 02	Data Datum 04.04.2013
Nr. pages	Dat.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **29.03.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr.AKK-03-448/13 për ztr. *Ilir Pushka – Ish Këshilltar Politik në kabinetin e Ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion dhe rrjedhimisht nuk ka situatë të konfliktit të interesit.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-448-13, për Zyrtarin e lartë, ztr. Ilir Pushka – Këshilltar Politik në Kabinetin e Ministrit të Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, dhe njëkohësisht njëri nga personat e autorizuar të dy biznese private, “Epcos” sh.p.k. dhe “Fabrika e Vajit të Lulediellit” sh.p.k. është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastet me numër protokoli AKK-03-447/13, dhe AKK-03-448-13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit të lartë, ztr. Pushka i është dërguar njoftimi me një shkresë zyrtare nga Agjencia, pas të cilës ztr. Pushka, ka qenë në takim me zyrtarët e Agjencisë, duke sjellë edhe një shkresë njoftuese (DPKI-03-870/13), në të cilën ka njoftuar se, tashmë, ai është një ish zyrtar i lartë, sepse që nga data 08.02.2013 me Vendim të Ministrit të FSK-së, nr.217/433, është shkarkuar nga pozita e të qenurit Këshilltar Politik në kabinetin e Ministrit, dhe rrjedhimisht nuk është as në listën e zyrtarëve të lartë.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit, pasi që ztr. Pushka, tashmë, nuk ushtron funksionin si zyrtar publik në Qeverinë e Kosovës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

